



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 korrik 2014
Nr. ref.: RK683/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI81/14

Parashtrues

Avni Zogaj

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Avni Zogaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili është duke e vuajtur dënimin me burg në Qendrën Korrektuese në Dubravë, komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, *“e drejta e tij për zbutje të dënimit duke u thirrur në ligj, i është humbur nga gjyqtarët dhe prokurorët”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI81/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI81/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 11 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.
9. Më 2 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 shkurt 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 61/2004, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të vrasjes dhe mbajtjen në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe i shqiptoi dënim unik prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetësh burgim.

11. Më 27 shtator 2006, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006, aprovohet pjesërisht ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 61/2004, i 6 shkurtit 2006, lidhur me vendimin për dënim, ashtu që parashtruesit të kërkesës iu shqiptua dënimi unik prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh burgim.
12. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me propozim që *“kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimi i formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006 të 27 shtatorit 2006, të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë”*.
13. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pzd. nr. 28/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006, të 27 shtatorit 2006, me arsyetimin si në vijim:

“Disa nga rrethanat e cekura për kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit si ajo se është familjar, mbajtës i vetëm i familjes, baba i dy fëmijëve njeri prej të cilëve është me aftësi të kufizuara, se për fëmijët përkujdeset nëna e të dënuarit e cila ka probleme shëndetësore, kanë qenë të njohura për gjykatat. Rrethana e re e pretenduar në kërkesë se kujdestarja-gjyshja e fëmijëve është në gjendje të vështërsuar shëndetësore si dhe udhëzimi për hulumtime diagnostike, nuk vërtetojnë gjendjen e paqëndrueshme shëndetësore e as paaftësinë e saj që të jetë kujdestare e fëmijëve të djalit të saj të dënuarit Avni Zogaj. Rrethana e re e pretenduar në kërkesë, gjendja shëndetësore e kujdestares së fëmijëve Rahime Zogaj dhe pamundësia e saj për përkujdesjen ndaj fëmijëve, nuk është e natyrës së tillë që konform dispozitës së nenit 429 të KPPK, të merret si bazë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë, çka do të thotë se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i bazuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“për të katërtën herë më refuzohet kërkesa për zbutje të dënimit, është më se e saktë se realisht e saktësisht ekzistojnë rrethana të reja për zbutje të dënimi, gjykatësit dhe prokurorët e shtetit janë të thirrur që të mbrojnë ligjin për të cilin janë betuar para shtetit dhe para zotit, por jo që të shkelin ligjin vetëm se një qytetar si unë e ka thyer ligjin është dënuar duke u thirrur në ligj nga ana e gjykatësve dhe prokurorve dhe ma humbin të drejtën për zbutje të dënimit duke u thirrur në po të njëjtin ligj.”*
15. Duke u bazuar në çka është thënë në kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që *“të shiqoni lëndën, të shiqoni faktet, ankesat, propozimet, refuzimet dhe të shifni se a egziston betimi i dhënë për zemërsisht (mendohet në gjyqtarë dhe prokurorë), apo është sipërfaqësore”*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
18. Gjykata i referohet gjithashtu nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
19. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
...
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.
20. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit për shkelje lidhur me *“humbjen e së drejtës së tij për zbutje të dënimit duke u thirrur në ligj nga gjyqtarët dhe prokurorët”*, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1990-I).
21. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, i 2 prillit 2014, në arsyetimin e tij, shpjegon në detaje arsyet për refuzimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
22. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë para Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës

Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064, i 30 qershorit 2009).

24. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të tregojë dhe të dëshmojë se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
25. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani